  - Pasuri Nr.59/17/1, Vol.15, Fq.130, ZK.2365, e llojit truall+ndërtesë, me sip.300 m<sup>2</sup>, nga e cila 119.67 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të shtetasve Mustafa Martinaj dhe Vasilika Martinaj. Kjo pasuri e paluajtshme është përfituar me leje legalizimi, datë regjistrimi 09.04.2020.
  - Pasuri Nr.1854/7, Vol.12, Fq.52, ZK.1673, e llojit arë, me sip. 2 543 m<sup>2</sup>, me adresë Fushë-Kuqe, Kurbin, në emër të shtetasit Mustafa Martinaj.
  - Pasuri Nr.1854/8, Vol.12, Fq.53, ZK.1673, e llojit arë+ndërtesë, me sip.410 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 136.74 m<sup>2</sup> (baza) dhe sip.ndërtimi gjithsej 540.29 m<sup>2</sup>, adresë Fushë-Kuqe, Kurbin, në emër të shtetasve Mustafa Martinaj dhe Vasilika Martinaj.
  - Pasurinë e llojit “Arë” nr pasurie 530/16, vol.29, fq.124, zk.2679, me sip.120 m<sup>2</sup>, në shumën 800 000 lekë, dhuruar nga Ervis Martinaj shtetases Bisere Hato.
  - Pasurinë e llojit “Truall+Ndërtesë”, me nr pasurie 530/15, vol.29, fq.123, zk.2679, me sip.580 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë sip 123.3 m<sup>2</sup>, në shumën 8 443 510 lekë, dhuruar nga Ervis Martinaj shtetases Bisere Hato.
  - Pasurinë e llojit “Apartament”, Nr pasurie 6/121+2-10, zk.8160, vol.22, fq.72, me sip.105 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “Dervish Hima” Tiranë. Shtetasi Ervis Martinaj, në cilësinë e dhuruesit, i ka dhuruar shtetases Gelmona Tarja.

#### **Shoqëritë apo subjekte ekonomike të identifikuar me aksionerë sipas kuotave janë:**

- Shoqëria “**KING KASINO**” sha, me NIPT Nr.L21407007D, me aksioner 100% Ervis Martinaj, statusi pezulluar me datë 20.05.2015.



- Shoqëria “ALBANIAN BASTE LIVE” sha, me NIPT Nr.L21620006U, aksioner me 100% Kol Palika, statusi aktiv, Ervis Martinaj është Administrator dhe lidhjet e tij familjare dhe miqësore anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.
- Shoqëria “ALBA TELECOMMUNICATION” shpk, me NIPT Nr.L22404014T, me 50% aksioner Ervis Martinaj dhe 50% i ka shtetasi Albelice Prospero, me status pezulluar me date 21.12.2017.
- Shoqëria “MATI UNION” shpk, me NIPT Nr.K37509322U, aksioner me 100%, Mustafa Martinaj, statusi Aktiv.
- Shoqëria “MARTINAJ E.M” shpk, me NIPT Nr.L87730301A, aksioner Mustafa Martinaj me 100%, statusi aktiv.
- Shoqëria “EUROVIS” shpk, me NIPT Nr.L32402030P, me aksioner 100% Vasilika Martinaj, statusi çregjistruar me datë 21.12.2022.
- Subjekti “Vasilika Martinaj” PF me NIPT Nr. L21515022U, me status çregjistruar date 16.08.2022.
- Subjekti “Ervis Martinaj” PF me NIPT Nr.K61927004F, me status aktiv .
- Shoqëria “REAL FENIX” shpk, me NIPT Nr.L82201012L, me aksioner 100% Roberta Martinaj, me status aktiv .
- Subjekti “Erjona Martinaj” PF me NIPT Nr.L11304052C, me status çregjistruar me date 06.09.2018.
- Subjekti “Drenica Martinaj” PF me NIPT Nr.M21417037G, me status aktiv.
- Subjekti “Valentino Kaçorri” PF me NIPT Nr.M21710004E, me status aktiv.
- Shoqëria “S.P.E Energy” shpk, me NIPT Nr.L22420002H, me aksioner 100% Valentino Kaçorri, me status aktiv.
- Shoqëria “S.P.E Gjadër” shpk, me NIPT Nr.L32120012G, me aksioner 21% S.P.E Energy, 14% shoqëria “EUES Energy”, 61% “Rafaelo 2002” dhe 4% shoqëria “Vllaznimi”, me status pezulluar me date 01.09.2022.
- Shoqëria “BUSINESS CONSULTING ENTERPRICE” shpk, me NIPT Nr.L51706026Q, me aksioner 10% Valentino Kaçorri por është larguar me datë 20.10.2016, i ka dhuruar këto aksione shtetasi Maurizio Borsetti.

**20.1.** Nga verifikimet e mëtejshme të kryera në funksion të procedimit Nr. 75 të vitit 2022, është identifikuar dhe një pasuri me Nr.36/41, Vol.7, Faq.119, ZK.3550, me sipërfaqe trualli 700 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 171 m<sup>2</sup> , godina është një katëshe dhe ka bodrum dhe një kat papafingo, me adresë Surrel Tiranë. Kjo banesë është me sipërfaqe totale 465 m<sup>2</sup>, është ne pronësi



REPUBLIKA E SHqipërisë  
PROKURORIA  
GENERALE

të shtetasit Fatmir Ahmet Vuthaj. Gjatë kontrollit të ushtruar në këtë banesë më datë 07.01.2023 bazuar në Vendimin Nr. 21, datë 06.01.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka rezultuar se i është dhënë me qera shtetases Vera Gjoka, e cila është vjehrra e shtetasit Ervis Martinaj. Në ambientet e kësaj banese janë gjetur dokumenta të shtetasit Ervis Martinaj dhe familjarëve të tij.

**20.1.1.** Gjithashtu, në lidhje me këtë pasuri i është marrë deklaram shtetasit Fatmir Vuthaj. Ai ka deklaruar se: **“se disponon një banesë në Surrel, Tiranë të cilën e ka blerë nga shtetasi Dritan Dautaj në shumën 170 000 euro. Ai deklaron se me sa i kujtohej këtë shumë ai e kam derdhur në bankë për likuidim pjesor të çmimit të godinës. Dhe pjesën tjetër të parave, që i duhej t’ia jepte Dritan Dautaj, deklaron që është bërë një marrëveshje midis shtetasit Ervis Martinaj dhe shtetasit Dritan Dautaj, por jo në prezencën dhe dijeninë tij. Nuk e di sa është vlera që Ervis i ka dhënë shtetasit Dritan Dautaj. Kjo banesë është blerë nga ana e tij në vitin 2017 dhe unë nuk ka jetuar asnjëherë aty. Për blerjen e kësaj banese i është sugjeruar nga shtetasi Ervis Martinaj, por paratë i vura ai. Për këtë ai ka marrë një kredi në Bankën “Union” në shumën 30 000 000 lekë dhe nga këto ka pa paguar shumën 20 000 000 lekë. Që nga muaji Dhjetor i vitit 2017 dhe në vazhdim ai kemi bërë një kontratë noteriale sipas së cilës unë i ka dhënë me qera banesën shtetases Vera Gjoka, e cila është vjehrra e shtetasit Ervis Martinaj, në shumën 30 000 lekë në muaj. Paratë e qerasë ia jepnin familjarët e Ervisit si Mustafai (babai), Drenica motra e tij dhe Roberta bashkëshortja e Ervisit. Paratë i ka marrë cash një herë në gjashtë muaj. Ai deklaron se sugjerimin për të blerë këtë pasuri ia ka bërë Ervisi për shkak të njohjeve që ai kishte me Mustafa Martinaj dhe gjithashtu Ervisi i ka thënë që “- të investojmë që të përfitojmë nga tregu sepse do të bëhet zonë e zhvilluar - “Gjithashtu ky shtetas ka patur dhe ka mardhënie financiare vetëm me shtetasin Mustafa Martinaj, pasi ai ka dalë garantor në kredinë, që ai ka marrë pranë Bankës “Union”, në shumën 30 000 000 lekë-“, ndërsa me shtetasin Ervis Martinaj, gjashtë muaj pasi bleu godinën në Surrel ka shkëputur çdo mardhënie. Ai deklaron se një pjesë të kësaj kredie e ka përdorur për të blerë banesën që ndodhet në këtë pasuri. Ai deklaron gjithashtu se godina, që ai ka blerë ka qënë vetëm si objekt i suvatuar, me dyer dhe dritare duralumini, e pa arreduar, e shtruar me pllaka të thjeshta. Gjithë investimi, që ka sjellë godinën, në gjendjen që është sot nuk është bërë nga ana ime dhe nuk mund të thote se kush i ka bërë pasi ai nuk kam jetuar asnjëherë aty-“.**

**20.1.2.** Nisur nga këto të dhëna sipas prokurorisë rezulton se mbi këte pasuri është investuar në vlera të larta monetare nga shtetasi Ervis Mustafa Martinaj. **Prandaj, lidhur me pasurinë Nr .36/41, Vol.7, Faq.119, ZK.3550, me sipërfaqe trualli 700 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 171 m<sup>2</sup>, me adresë: Surrel Tiranë, nisur nga fakti që: i) pronari “de juro” e ka paguar një vlerë 170.000 euro e cila dukshëm nuk përputhet me vlerën de facto të kësaj pasurie; ii) pjesa tjetër mbetur nga shuma totale 355.000 euro e përcaktuar në kontratë, është paguar me marrëveshje nga Ervis Martinaj, shitësit Dritan Dautaj; iii) që sipas deklarimeve të pronarit aty**

janë bërë investime të tjera që nuk i ka bërë ai, dhe nuk di të deklarojë së kush i ka bërë; iv) e ka blerë me propozim të të hetuarit Ervis Martinaj; v) për kredinë e marrë ka dalë garant babai i Ervis Martinaj, shtetasi Mustafa Martinaj; vi) pronari nga momenti që e bleu nuk jetoi asnjë ditë, por ia lëshoi me qera vjehrrës së të hetuarit Ervis Martinaj; vii) vlera e qerasë mujore është dukshëm e ulët për këtë pasuri 30.000 lekë; viii) nga fakti që aty u gjetën prova që lidhen me të Ervis Martinaj, të cojnë në konkluzionin që kjo pasuri vetëm de juro është regjistruar në emër të Fatmir Vuthaj por “de facto”, ajo zotërohet nga i hetuari Ervis Martinaj, e familjarë të tij, si investuesi real i kësaj pasurie, i cili e ka fshehur në emër të Fatmir Vuthaj.

21. Gjithashtu, sipas prokurorisë edhe pasuritë e dhuruara me kontratat e dhurimit me përfitues shtetasit Besere Hato dhe Gelmona Tarja, dhe dhurues i hetuari Ervis Martinaj, dyshohet se kanë burime të paligjshme nga aktiviteti kriminal i të dyshuarit Ervis Martinaj dhe se janë fshehura në emër të këtyre shtetaseve e për këtë arsye duhet proceduar me sekuestrimin e tyre. Po ashtu, prokuroria thekson se nga pasuritë e identifikuar me përjashtim të disa pasurive, të cilët janë përfituar me kontrate dhurimi apo me AMTP, pasuritë e tjera janë përfituar me blerje me të ardhura të dyshuara nga aktiviteti i pa ligjshëm i shtetasit Ervis Martinaj, duke i shpërndarë ato dhe në lidhjet e tij familjare dhe miqësore.

22. Mbashtetur në faktet e mësipërme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar arsyeton se duke u nisur nga rezultatet e veprimeve e verifikimeve pasurore të kryera rezulton se ndodhemi në rastin kur plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret për marrjen e masave parandaluese pasurore për pasuritë në zotërim/pronësi të shtetasit Ervis Martinaj, dhe konkretisht; **Së pari**, pasuritë objekt i kërkesës për sekuestrim janë pasuri që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Ervis Martinaj, është përfshirë në veprimtarinë kriminale që përfshihen në ligji antimafia. **Së dyti**, pasuritë e mësipërme, zotërohen nga shtetasi Ervis Martinaj, dhe personave të lidhur me të, dhe ekzistojnë dyshime se janë të pajustificuara nga burime të ligjshme. **Së treti**, ka arsye të bazuara për të besuar në lidhur me pasurinë e mësipërme ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e saj tek persona të tjerë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e kësaj pasurie. Për këto arsye, në bazë të neneve 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, kërkon pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

### III. Vlerësimi i Gjykatës.

#### 1. Lidhur me kërkesën për sekuestrimin e pasurive sipas Ligjit nr. 10192

23. Nuk ka dyshim që një nga funksionet e shtetit ligjor është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe e shoqërisë nga veprimtaria kriminale. Ky përbën edhe bazën, por



REPUBLIKA E SHQIPËRI  
PROKURORIA GJYKIMORE  
E TË LARTË

njëkohësisht, edhe kufirin logjik të pushtetit ndëshkues të shtetit. Në këtë këndvështrim, rëndësi ka, jo vetëm goditja e kriminalitetit nëpërmjet mënyrës represive të sanksionimit të dënimeve penale të atyre fakteve dhe sjelljeve penalisht të qortueshme që prekin një të mirë juridike apo interes kushtetues të mbrojtur nga sistemi penal, por edhe parashikimi i një sërë mjetesh dhe i një sistemi ligjor në gjendje të parandalojë krijimin e kushteve – qofshin ato, sociale, ekonomike, kulturore – që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë kriminale, si një karakteristikë e sistemeve penale bashkëkohore për mbrojtjen e shoqërisë nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore. **Konfiskimi civil dhe sekuestrimi i pasurive që rrjedhin nga vepra penale, përbën një mjet ligjor parandalues-preventiv në luftën kundër veprimtarive më të rrezikshme kriminale, i cili duhet të realizohet në përputhje me kriteret, kushtet dhe procedurën, të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe që ka për qëllim të parandalojë krijimin dhe përdorimin e pasurisë në veprimtaritë kriminale, duke synuar goditjen dhe parandalimin e kriminalitetit edhe me masa pasurore.**<sup>4</sup> Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 2 të Ligji Nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, nën titullin “Qëllimi” ku parashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe krimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.”*

24. Gjykata çmon se, detyrimi për adoptimin e konfiskimit civil të pabazuar në dënimin penal, rrjedh nga akte ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa e Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizimit dhe Konventa e Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Depistimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit.

25. Procedimi i parashikuar në Ligjin Nr. 10192 është një procedim i veçantë autonom nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ky ligj. Siç e konfirmon edhe neni 5, paragrafi 1, ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet procedurës së caktimit të masave parandaluese dhe procedimit penal, duke vendosur se *“Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji”*. Prosesi civil me natyrë parandaluese vijon në mënyrë autonome, pavarësisht nga ecuria e hetimit paraprak ose shkalla e shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, sepse nuk është pjesë e fazës së hetimeve paraprake në procedimin penal dhe, për pasojë, nuk

<sup>4</sup> Shiko vendimin Nr. 224, datë 09.12.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

është një masë e sigurimit pasuror në zbatim të neneve 270-276 të KPP-së. Procedimi parandalues nuk ka si objekt vërtetimin e fajësisë së personit, por zbatimin e masave parandaluese, me qëllim shmangien e ushtrimit të veprimtarisë kriminale.<sup>5</sup> Prandaj, Gjykta arrin në përfundimin se, procedimi parandalues sipas Ligjit Nr. 10192, është autonom në raport me procedimin penal (dhe atë civil). Procedimi preventiv mund të fillojë, vazhdojë e përfundojë, si gjatë ashtu edhe pas përfundimit të një procedimi penal. Nga ana tjetër, duke qënë procedime autonome ato nuk janë procedime të tilla që përjashtojnë fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e njëra tjetrës, përse kohë pretendohet a vërtetohet se ka një person të dyshuar në kuptim të Ligjit Nr. 10192 për kryerjen e një vepre penale, ndaj të cilit është duke u zhvilluar apo ka përfunduar një procedim penal.<sup>6</sup>

25.1. Autonomia e procedimit penal dhe atij parandalues, rezulton edhe nga përmbajtja e dispozitës së nenit 5 pika 3 të Ligjit Nr. 10192, nën titullin "*Marrëdhënia me procedimin penal*" ku parashikohet shprehimisht se: "*3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, 3 gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.*". Kjo dispozitë ndër të tjera konfirmon edhe faktin që këto dy procedime nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi. Nga dispozita e nenit 5 pika 3 rezulton se procedimi penal ka përparësi, përderisa masat përkatëse pasurore të vendosura gjatë gjykimit parandalues mbeten të pezulluara, nuk ekzekutohen, dërisa të përfundojë procedimi penal dhe gjykata penale të shprehet, ndërmjet të tjerave, edhe për masat e sigurimit pasuror të vendosura në atë gjykim penal. Nga interpretimi logjik i kësaj dispozite arrihet në përfundimin se, masat pasurore të vendosura në procedimin parandalues shuhen vetvetiu vetëm nëse gjykata penale vendos konfiskimin për të nëejtat pasuri. Por këto masa nuk shuhen në këtë mënyrë nëse gjykata e procedimit penal nuk vendos konfiskimin, apo vendos heqjen e masave të sigurimit pasuror. Ato mbeten në fuqi, mund të kthehen në masa konfiskimi, apo mund të rishikohen pas shqyrtimit autonom të çështjes nga gjykata e procedimit parandalues, e cila çmon në tërësi, të gjitha rrethanat dhe provat e paraqitura nga subjektet pjesëmarrës në gjykimin parandalues, ërveç atyre që kanë të bëjnë me cilësinë e personit të dyshuar, të rezultuara në përfundimet e arritura nga gjykata e procedimit penal lidhur me dhënien e një vendimi dënimi, pafajësie, a pushimi të çështjes në ngarkim të personit të dyshuar.<sup>7</sup>

25.2. Gjithashtu, Gjykata çmon të theksoj se **procedimi parandalues sipas këtij ligji është i lidhur domosdoshmërisht me qënien e një procedimi penal, pavarësisht se në cilën fazë ndodhet ky i fundit, apo nëse ka përfunduar.** Në këtë përfundim ka arritur dhe Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 99, datë 13.07.2011, ku ndër të tjera arsyetohet se:

<sup>5</sup> Shiko vendimin Nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>6</sup> Shiko vendimin unifikues Nr. 1, datë 25.01.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>7</sup> Po aty.



[...] Ky Kolegj vlerëson se pavarësisht autonomisë që kanë nga njëri tjetri të dyja procedimet/vendimet e sipërpërmendura, gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për vendosjen e masave parandaluese nuk mund të mos konsiderojë dhe marrë parasysh përfundimet e arritura nga gjykatat në gjykimin penal.....Ky Kolegj vlerëson se në kushtet kur për një pjesë të pasurive është disponuar me vendim penal të formës së prerë, gjykata gjatë gjykimit parandalues, bazuar në ligjin 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", nuk duhej të kishte pranuar kërkesën për konfiskim të pasurive të tjera për të cilat gjykata penale nuk kishte pranuar konfiskimin. Do të ishte plotësisht e justifikuar ligjërisht një kërkesë për konfiskim pasurie nëse do të ishte zbuluar ekzistenca e pasurive të tjera të të dënuarit, ose personave të lidhur me të, që dyshohet se mund të jenë krijuar prej aktivitetit kriminal dhe që nuk dihet se ekzistonin në momentin e hetimit dhe gjykimit në lidhje me fajësinë (proçesi penal), por në rastin në shqyrtim ekzistenca e këtyre pasurive dihej më së pari dhe gjykatat penale kanë hetuar origjinën e krijimit duke mos gjetur lidhje midis mënyrës së fitimit të tyre dhe aktivitetit kriminal të të akuzuarve.[...]

25.3. Gjykimi parandalues nuk kushtezohet nga parimet dhe rregullat e shqyrtimit të kërkesave të palëve gjatë hetimeve paraprake (neni 13/2/b i K.Pr.Penale). Gjykata vëren se këtë dallim ndërmjet procesit penal dhe procesit të masave parandaluese dhe zbatimin e garancive të procesit penal në procedimin e masave parandaluese e vë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese Italiane, kur shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit italian të vitit 1956 (për masat parandaluese ndaj pasurive të krimit të organizuar). Gjykata Kushtetuese Italiane, me vendimin nr. 27 të vitit 1959 dhe vendimin nr. 23 të vitit 1964 ka mbajtur këtë qëndrim: "...në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Me fjalë të tjera një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme. Megjithatë sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit" (Përkthim i GjK) (Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane të vitit 1964).".

26. Gjykata vëren se neni 3 i Ligjit Nr. 10192 parashikon se dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për: a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal; b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal; c) kryerjen

e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal; ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal; d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm. **2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:** a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta; b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre. 3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë. 4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë. 5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes. 6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

27. Gjykata vëren se Ligji Nr. 10192 lidhet me zbatimin e një regjimi juridik të posaçëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që burojnë ose lidhen me disa nga dukuritë më të rënda kriminale, me një lloj procedimi të posaçëm të natyrës parandaluese dhe goditëse ndaj këtyre dukurive. Në thelb, në nenin 4 të Ligjit Nr. 10192 nën titullin “**Masa parandaluese**” ku parashikohet shprehimisht se: “*Në kuptim të këtij ligji, “Masë parandaluese” është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre.*”, parashikohen dy lloj masash parandaluese, të cilat janë sekuestrimi dhe konfiskimi. Neni 11 i ligjit cakton kriteret për sekuestrim të pasurisë, duke parashikuar: “1. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave, sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se



personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlicjohen prej tyre, si dhe kur: a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale. 2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të këtij neni.”

27.1. Gjykata çmon se, dallimi ndërmjet këtyre dy masave parandaluese nuk qëndron në faktin se njëra masë duhet detyrimisht të paraprijë masën tjetër. **Sekuestrimi ka si tipare të tij urgjencën e ndërhyrjes (gjykata vendos brenda 5 ditëve), si dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës, pra heqjen e të drejtës së administrimit të pronës për një periudhë të caktuar kohore.** Nga ana tjetër, konfiskimi ka si tipare të tij verifikimin me të thelluar të kërkesës nga ana e gjykatës, si dhe kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit. Në rast se prokurori çmon se nuk ekziston rreziku për humbje, marrje ose tjetërsim të pasurisë ose rreziku i përdorimit të pasurisë për lehtësimin e veprimtarisë kriminale, gjatë kohës prej 3 muajve që i nevojitet gjykatës për shqyrtimin e kërkesës për konfiskim (pra, nuk jemi përpara kushteve të urgjencës për heqjen e të drejtës për administrimin e pasurisë), prokurori mund të paraqesë kërkesë për konfiskim pa kërkuar fillimisht zbatimin e masës së sekuestrimit.<sup>8</sup>

27.2. Masat parandaluese janë bërë objekt shqyrtimit edhe në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Kjo e fundit, për masën e sekuestrimit të Aktit Italian të vitit 1965, është shprehur se kjo masë nuk ka për qëllim që të privojë kërkuuesin nga prona e tij, por vetëm e ndalon atë që ta përdorë; sekuestrimi është qartazi një masë që ka për qëllim të sigurojë që pasuria, e cila duket se është fryt i veprimtarive të paligjshme të kryera në dëm të bashkësisë, të mund të konfiskohet më tej, nëse është e nevojshme; masa si e tillë është e justifikueshme nga interesi i përgjithshëm dhe, duke pasur parasysh fuqinë e rrezikshme ekonomike të një organizate si Mafia, nuk mund të thuhet se marrja e saj në këtë fazë të procedimit është disproporcionale me qëllimin që synohet të arrihet (*Shih çështjen Raimonondo v. Italisë, vendimi i GJEDNJ-së i 22 shkurt 1994, para.27*). Për konfiskimin, në këtë çështje GJEDNJ-ja ka pranuar se konfiskimi përbën një privim të pronës. Sipas saj, konfiskimi ka synuar të ndjekë një qëllim, që ishte në interesin e përgjithshëm, pra kërkonte të siguronte se përdorimi i pronës në fjalë nuk do të sillte fitime për kërkuuesin ose organizatën kriminale, anëtar i së cilës ai dyshohej se ishte, në dëm të bashkësisë. GJEDNJ-ja i

<sup>8</sup> Shiko vendimin Nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese.



njuh një hapësirë të gjerë vlerësimi shtetit italian. Ajo shprehet, ndër të tjera, se konfiskimi, i cili është hartuar për të bllokuar lëvizjen e kapitaleve të dyshimta, është një armë efektive dhe e nevojshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe Mafies. Prandaj duket proporcionale me qëllimin që synon të arrihet. (Shih çështjen *Raimondo të GJEDNJ-së paragrafi 30*). Në çështjen *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 24 tetor 1986, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, shprehet se paragrafi 2i nenit 1 Protokollit 1 i KEDNJ-së i njuh të drejtën shteteve të miratojnë ato ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Por duhet të ekzistojë një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet masës së marrë dhe qëllimit që synohet të arrihet; me fjalë të tjera, duhet të shqyrtohet nëse ka një balancë të drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit ose individëve në fjalë. Në përcaktimin e kësaj baraspeshe, GJEDNJ-ja njuh që shteti gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi si për zgjedhjen e mjeteve, ashtu edhe në përcaktimin e pasojave të masës, të cilat justifikohen nga interesi i përgjithshëm për qëllim të arritjes së qëllimit të ligjit në fjalë. Në çështjen *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë* i 5 korrik 2001, GJEDNJ-ja vendosi se edhe pse masa në fjalë sillte privimin e pronës, kjo përbente një kontroll të përdorimit të pronës në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili u jep të drejtën shteteve që të miratojnë ligje që i konsiderojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Ajo ka theksuar edhe se masa e kundërshtuar bën pjesë në një politikë për parandalimin e krimit. GJEDNJ-ja shprehet se konfiskimi në këtë rast ka synuar të parandalonte përdorimin e paligjshëm, në një mënyrë të rrezikshme për shoqërinë, të zotërimeve, origjinën e ligjshme e të cilave nuk është vërtetuar. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje, sipas saj, i shërben interesit publik dhe është në përputhje me qëllimin legjitim që synon të arrijë.<sup>9</sup>

**28.** Lidhur me barrën e provës në kuadrin e procedimit pasuror, në vendimin Nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera arsyetohet se: *[...]38. Gjykata, në ligjin objekt shqyrtimi vlerëson se, veçanërisht formulimet e nenit 11, paragrafi 1 (kriteret për sekuestrim), ku parashikohet se prokurori bën kërkesë të motivuar dhe nenit 21 (kërkesa për konfiskim dhe barra e provës), ku prokurori përsëri duhet t'i paraqesë gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa, barra e provës fillimisht i takon prokurorit për të argumentuar dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, se një person është pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafikim sipas veprave të parashikuara në nenin 3. Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë; të tregojë nga ana e tij se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre, dhe si rezultat, kalimin e barrës së provës personit të dyshuar. Pas*

<sup>9</sup> Po aty.



kësaj, barra e provës kalon te personi i dyshuar, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre. Më pas është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënten e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj. Pra, në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë proces, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria. Në vijim të këtyre arsyetimeve dhe argumenteve për nevojën e dallimit ndërmjet procesit penal dhe procesit parandalues, garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues, të sanksionuar nga ligji objekt shqyrtimi.[....]

28.2. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për sekuestrimin e pasurisë sipas objektit të kërkesës është e bazuar në prova dhe në ligj. Kjo përa arsyet si më poshtë vijon: **Së pari**, pasuritë objekt i kërkesës për sekuestrim janë pasuri që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Ervis Martinaj, është përfshirë në veprimtarinë kriminale që përfshihen në ligji antimafia. **Së dyti**, pasuritë e mësipërme, zotërohen nga shtetasi Ervis Martinaj, dhe personave të lidhur me të, dhe ekzistojnë dyshime se janë të pajustificuara nga burime të ligjshme, si dhe personat e tretë e mbajnë pasurinë nëpërmjet veprimeve juridike fiktive ose të simuluar. **Së treti**, ka arsye të bazuara për të besuar në lidhur me pasurinë e mësipërme ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e saj tek persona të tjerë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e kësaj pasurie.

## 2. Lidhur me administrimin e pasurive të sekuestruara.

29. Në nenin 15 të Ligjit Nr. 10192 nën titullin “Administratori i pasurisë së sekuestruar” parashikohet shprehimisht se: “1. Gjykata në vendimin e sekuestrimit të pasurisë cakton Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si administratore të këtyre pasurive. Agjencia vë në dispozicion të gjykatës listën e administratorëve të punësuar pranë saj të paktën 1 (një) herë në vit dhe tregon kriteret e caktimit të tyre. 2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara mund të kërkojë ndihmën e ekspertëve ose të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë.”, ndërsa në nenin 16 të këtij Ligji nën titullin “Detyrat e administratorit”, parashikohet shprehimisht se: “1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ajo ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive. 2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të

*Sekuestruara dhe të Konfiskuara për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, paraqet çdo kërkesë të nevojshme pranë prokurorisë, apo çdo institucioni tjetër shtetëror. 3. Gjykata ose prokurori mund t'i kërkojë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në çdo kohë informacion për mënyrën e administrimit të pasurisë. Ky informacion jepet nga Agjencia brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, me vendimin e sekuestrimit, Gjykata është e detyruar të caktojë Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si administratore të këtyre pasurive.*

### **3. Lidhur me të drejtën e ankimit.**

**33.** Në nenin 7 të Ligjit Nr. 10192 nën titullin **“Kompetenca dhe përbërja e gjykatës”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. 2. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të dytë, nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas rregullit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. 3. Zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, dispozitat e paragrafit 1, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale. 4. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë me një gjyqtar. Ankimi kundër vendimit për marrjen e masës parandaluese shqyrtohet nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.”*, ndërsa në nenin 12 të këtij Ligji nën titullin **“Ankimi”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. 2. Kundër vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. 3. Ankimi, sipas pikës 1 ose 2 të këtij neni, nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. 4. Kur prokurori paraqet ankim kundër revokimit të sekuestrimit ose refuzimit të kërkesës për konfiskim, ekzekutimi i masës së ankimuar pezullohet deri në marrjen e vendimit nga gjykata e apelit.”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se ndaj vendimit të sekuestrimit në rastin konkret mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas afateve të parashikuara në K.Pr.Penale.

**33.1.** Në rastin konkret legjitimohen për të bërë ankim personat që kanë interes pasuror mbi pasuritë e sekuestruara.

### **PËR KËTO ARSYE:**



Gjykata, në bazë dhe për zbatim të neneve 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit Nr.101/2009, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar,

ATA  
RUPM  
DHE  
KORRUPSIONIT  
DHE  
KRIIMEVE  
TË  
TJERA  
NËPËRMJET  
MASAVE  
PARANDALUESE  
KUNDËR  
PASURISË

### VENDOSI

1. Pranimin kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Sekuestrimi i pasurive si më poshtë vijon:
  1. Shoqëria “**KING KASINO**” sha, me NIPT Nr.L21407007D, me aksioner 100% **Ervis Martinaj**, statusi pezulluar me datë 20.05.2015.
  2. 50% te aksioneve dhe aseteve te shoqërisë “**ALBA TELECOMMUNICATION**” shpk, me NIPT Nr.L22404014T, të zotëruara nga shtetasi **Ervis Martinaj**.
  3. Shoqëria “**MATI UNION**” shpk, me NIPT Nr.K37509322U, aksioner me 100%, **Mustafa Martinaj**, statusi Aktiv.
  4. Shoqëria “**MARTINAJ E.M**” shpk, me NIPT Nr.L87730301A, aksioner **Mustafa Martinaj** me 100%, statusi aktiv.
  5. Subjekti “**Ervis Martinaj**” PF me NIPT Nr.K61927004F, me status akt.
  6. Shoqëria “**REAL FENIX**” shpk, me NIPT Nr.L82201012L, me aksioner 100% shtetësja **Roberta Martinaj**, me status aktiv.
  7. Subjekti “**Drenica Martinaj**” PF me NIPT Nr.M21417037G, me status aktiv.
  8. Subjekti “**Valentino Kaçorri**” PF me NIPT Nr.M21710004E, me status aktiv.
  9. Shoqëria “**S.P.E Energy**” shpk, me NIPT Nr.L22420002H, me aksioner 100% **Valentino Kaçorri**, me status aktiv.
  10. 21% të aksioneve dhe aseteve të shoqëria “**S.P.E Gjadër**” shpk, me NIPT Nr.L32120012G të zotëruara nga shoqëria “**S.P.E Energy**”, në të cilën shtetasi **Valentino Kaçorri** është aksioner me 100% të aksioneve.
  11. Automjeti tip autoveturë, i markës Smart, modeli Passion, me targa **AA 807 BC**, shasia Nr.WME4513001K165701, viti i prodhimit 2007, në pronësi të shtetases **Erjona Martinaj**;
  12. Automjeti tip autoveturë, i markës Land Rover, modeli Discovery, me targa **AB 131 AU**, shasia Nr.SALCA2BN8HH644737, viti i prodhimit 2016, në pronësi të shtetases **Erjona Martinaj**.
  13. Automjeti tip autoveturë, i markës Mercedes-Benz, modeli GLK 350, me targa **AB 925 HT**, ka patur targën (**AB 639 FS**), shasia Nr.WDC2049931G159629, viti i prodhimit 2013, në pronësi të shtetases

**Vasilika Martinaj.**

14. Automjeti tip autoveturë, i markës Fiat, modeli Fiesta, me targa AA 523 VJ, shasia Nr.WF0JXXGAJJB65647 viti i prodhimit 2011, në pronësi të shtetases **Vasilika Martinaj.**
15. Automjeti tip autoveturë, i markës BMW, modeli M 550, me targa AB 562 EZ, shasia Nr.WBA5D91030D970203, viti i prodhimit 2016. në pronësi të shtetasit **Vasilika Martinaj.**
16. Pasurie 24/15+1-28 vol.36, fq.51, zk.8602, me sip.82 m2 , me adresë lagjia "Pavarasia" Vlorë, Ap. Nr. 28, kati gjashtë teknik, në pronësi të shtetases **Drenica Martinaj.** Pasurie 2338/1, vol.15, fq.48, zk.2963, me sip.245 m2 , pasuri e llojit "Arë", me adresë Piqeras Sarandë, në pronësi të shtetasve **Ervis Martinaj dhe Roberta Martinaj.**
17. Pasuri e llojit "Njësi" ka numër pasurie 4/83/ND-N3, vol.23, fq.71, zk.8380, me sip. 137 m2, në pronësi të shtetases **Vasilika Martinaj.**
18. Pasuria Nr.246/4, Vol.3, Fq.161, ZK.1498, e llojit ullishte, me sip.9 800 m2, me adresë: Dobresh Tiranw. Kjo pasuri e paluajtshme është përfituar me kontratë shit-blerje nga shtetasi Mustafa Haxhi Martinaj. Aktualisht kjo pasuri e paluajtshme posedohet nga shoqëria "**Martinaj EM shpk**".
19. Pasuria Nr. 2093/2, Vol.11, Fq.114, ZK.1673, e llojit arë, me sip. 3 815 m2, me adresë Fushë-Kuqe, Kurbin, në emër të **Mustafa Haxhi Martinaj.**
20. Pasuria Nr. 10/15, Vol.5, Fq.82, ZK.2889, e llojit arë, me sip.7 000 m2, me adresë Patok, Kurbin, në emër të **Mustafa Haxhi Martinaj dhe Vasilika Martinaj.**
21. Pasuria Nr. 31, Vol.5, Fq.99, ZK.1673, e llojit arë, me sip.12 145 m2, me adresë Fushë-Kuqe, Kurbin, në emër të shtetases **Vasilika Martinaj.**
22. Pasuria Nr.10/13, Vol.5, Fq.71, ZK.2889, e llojit arë, me sip.1 973 m2, me adresë Patok, Kurbin, në emër të **Mustafa Haxhi Martinaj dhe Vasilika Martinaj.**
23. Pasuria Nr.10/10, Vol.5, Fq.65, ZK.2889, e llojit arë, me sip.7 050 m2, me adresë Patok, Kurbin, në emër të **Vasilika Martinaj.**
24. Pasuria Nr.28/79, Vol.11, Fq.209, ZK.1677, e llojit arë+truall, me sip.1 975 m2, nga e cila 815.34 m2 ndërtesë, me adresë Fushë-Milot, Kurbin. Kjo pasuri e paluajtshme është përfituar me kontratë shit-blerje nga shtetasit Mustafa Haxhi Martinaj dhe Vasilika Martinaj. Aktualisht kjo pasuri e paluajtshme posedohet të nga shoqëria "**Martinaj EM shpk**".
25. Pasuria Nr.28/80, Vol.11, Fq.210, ZK.1677, e llojit arë, me sip.1 632 m2, me adresë Fushë-Milot, Kurbin. Kjo pasuri e paluajtshme është përfituar me kontratë shit-blerje nga shtetasit **Mustafa Haxhi Martinaj dhe Vasilika**





4. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të mësipërme të ngarkohet Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Tiranë.
5. Me njoftimin e zotëruesve të pasurive të sekuestruara ngarkohet policia gjyqësore.
6. Ngarkohet Sekretaria e gjykatës t'i dërgoj, pa vonesë, dy kopje të vendimit të sekuestros Prokurorëve **Altin Dumani, Doloreza Musabelliu dhe Behar Dibra** të cilët kanë paraqitur kërkesën për sekuestro.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, me datë 23.01.2023



